

STATUTI

Adresa,
Lagja e Spitalit rr. "Muharrem Fejza" p.n.
Tel. 038 512 069 / 081 / 095
Fax . 038 512 069 212

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS



STATUTI

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS
INSTITUCION I PAVARUR, PROFESIONAL PËR
TRAJNIMIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE
BRENDA SISTEMIT GJYQËSOR NË KOSOVË

Prishtinë, janar 2008

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS

S T A T U T I

Në mbështetje të nenit 3.6.a dhe 11 të Ligjit për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, nr. 02/L-25, miratuar nga Kuvendi i Kosovës, nga Këshilli Drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës miratohet:

S T A T U T I

KREU I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Objekti

1.1 Instituti Gjyqësor i Kosovës (më tej “IGJK”) si organ i pavarur profesional ka statusin e personit juridik dhe gëzon pavarësi administrative dhe financiare për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave të caktuara me ligj.

1.2 Statuti i IGJK-së (më tutje “Statuti”) rregullon organizimin dhe funksionimin e brendshëm të IGJK-së, përgjegjësitë e organeve drejtuese, marrëdhëniet në mes të organeve drejtuese (Këshillit Drejtues / Drejtorit) dhe stafit të programit, si dhe administratës së IGJK-së, të drejtat dhe obligimet e IGJK-së në raport me pjesëmarrësit, trajnuesit dhe anasjelltas, si dhe rregullat për mësimdhënie, shkallën e kualifikimit dhe përvojës së trajnuesve.

Neni 2

IGJK ka shenjën identifikuese dhe vulën e vet. Vula e IGJK-së ka formë katërkëndëshe me ngjyrë të kaltër dhe në të është e shënuar shkurtesa “kji” dhe emërtimi i IGJK-së në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Neni 3

Emërtimi zyrtar i IGJK-së në gjuhën shqipe është “*Instituti Gjyqësor i Kosovës*”, në gjuhën angleze është “*Kosovo Judicial Institute*”, ndërsa në gjuhën serbe është “*Kosovski Institut za Pravosudje*”

Neni 4

Qëllimi

Statuti rregullon mbarëvajtjen e veprimtarisë së Institutit Gjyqësor të Kosovës, siguron rregulla unike për aftësim ligjor për pjesëmarrësit e trajnimeve, trajnuesit e përhershëm dhe të përkohshëm, si dhe garanton pjesëmarrjen aktive të kandidatëve në procesin trajnues dhe në aktivitete të tjera, që do të përcaktohen me rregulla të veçanta, në mënyrë të pavarur, të paanshme, pa dallim, etnik, racor, gjinor apo fetar.

KREU II

Dispozitat themelore

Neni 5

Aktivitetet e IGJK-së

IGJK gjatë punës së vet ushtron këto aktivitete:

- a. Organizon trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët të cilët janë duke ushtruar detyrën e gjyqtarit/prokurorit;
- b. Organizon dhe vlerëson provimin përgatitor në gjyqësi, me të cilin përzgjedh kandidatët potencialë për gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët do t'i nënshtrohen më pas programit fillestar të trajnimeve, dhe trajnime obligative për avancim;
- c. Organizon trajnime për kandidatët potencial për gjyqtarë dhe prokurorë;
- d. Organizon kurse trajnimi për avancimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë;
- e. Organizon kurse për aftësimin bazë të gjyqtarëve porotë;
- f. Organizon kurse për aftësimin e profesionistëve tjerë në lëmin e gjyqësisë, të identifikuar nga IGJK-ja;
- g. Në bashkëpunim me institucionet relevante në gjyqësi dhe prokurori përgatitë plane afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, me qëllim të ndërtimit të një sistemi të fortë, të paanshëm, të pavarur, efikas dhe në hap me standardet më të larta ndërkombëtare;
- h. Kryen hulumtime shkencore në fushën ligjore dhe gjyqësore për të identifikuar problemet rreth zbatimit të ligjeve;
- i. Realizon aktivitete me qëllim të përgatitjes së komentareve ligjeve, dhe
- j. Bën publikime nga fushat dhe aktivitetet e ndryshme profesionale me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në gjyqësorin e Kosovës.

Neni 6

Bashkëpunimi

IGJK për realizimin e aktiviteteve ka bashkëpunim të ngushtë me:

- a. Organet e pushtetit në Kosovë;

- b. Institucionet dhe organizatat relevante të sistemit gjyqësor të Kosovës, dhe
- c. Qendrat ndërkombëtare të trajnimit si dhe institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare.

KREU II

Organet drejtuese

Neni 7

Organet drejtuese të IGJK-së janë:

- a. Këshilli Drejtues dhe
- b. Drejtori.

Neni 8

Këshilli Drejtues

8.1. Organi më i lartë drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës është Këshilli Drejtues (në tekstin e mëtejme KD).

8.2. Përbërja e dhe përgjegjësitë kryesore të Këshillit Drejtues janë përcaktuar me Ligjin për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës.

8.3. Përveç përgjegjësisë të përcaktuara me ligj, Këshilli Drejtues ka edhe këto kompetenca:

- a. Miraton programet e trajnimeve dhe aktet tjera nënligjore të IGJK-së;
- b. Miraton përbërjen e Këshillit Programor;

- c. Miraton Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit të IGJK-së;
- d. Miraton raportet vjetore dhe prezanton ato te subjektet përkatëse;
- e. Zgjedhë komisionin për përgatitjen, realizimin dhe vlerësimin e provimit përgatitor,
- f. Në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor përcakton kriteret për pranimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor;
- g. Miraton përbërjen e anëtarëve të komisioneve pas propozimit të kryetarit të KD-së;
- h. Merr vendime tjera në përputhje me ligjin, statutin dhe aktet tjera të brendshme;
- i. Raporton në baza vjetore në Kuvendin e Kosovës, dhe
- j. Propozimet nga pika a deri g bëhen nga Drejtori i IGJK-së.

8.4. Këshilli Drejtues i realizon funksionet drejtuese në IGJK, duke u bazuar në raportet të cilat i merr nga drejtori.

8.5. Këshilli Drejtues nga përbërja e tij zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarin.

8.6. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjedhën me mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, por jo më shumë se 2 (dy) mandate.

8.7. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjedhën me 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm.

8.8. Kryetari dhe zëvendëskryetari mund të shkarkohen:

- a. Në bazë të kërkesës së tyre të bërë me shkrim;
- b. Për pamundësinë e përmbushjes së obligimeve të tyre në një periudhë më të gjatë se 6 muaj, dhe
- c. Nëse dënohen më shumë se gjashtë muaj burg për një veprë penale ose nëse me një vendim të plotfuqishëm gjyqësor u është hequr e drejta për ta ushtruar këtë funksion.

8.9. Anëtari i Këshillit Drejtues mund të shkarkohet:

- a. Në bazë të kërkesës së tyre të bërë me shkrim;
- b. Për pamundësinë e përmbushjes së obligimeve në një periudhë më të gjatë se 6 muaj;
- c. Nëse dënohet më shumë se gjashtë muaj burg për një veprë penale ose me një vendim të plotfuqishëm gjyqësor i është hequr e drejta për ta ushtruar këtë funksion dhe,
- d. Nëse nuk është më anëtarë i institucionit të cilën e ka përfaqësuar.

Neni 9

Mbledhjet e Këshillit Drejtues

9.1. Mbledhja e KD-së thirret nga Kryetari i tij, duke ftuar me shkrim anëtarët e KD-së, së paku 5 ditë pune para takimit. Të drejtën për të kërkuar mbledhjen e KD-së dhe përfshirjen e çështjeve në rendin e ditës e kanë edhe drejtori i IGJK-së dhe së paku 5 anëtarë të KD-së.

9.2. Ftesa për mbledhjet e rregullta mund të dërgohet me postë, postë elektronike, faks, ndërsa për mbledhjet e jashtëzakonshme edhe me telefon dhe sms më së voni një ditë para mbledhjes;

9.3. Së bashku me ftesën anëtarëve të Këshillit Drejtues duhet dërguar rendin e ditës.

9.4. Këshilli Drejtues mbanë mbledhje të rregullta së paku 4 herë në vit, por sipas nevojave të IGJK-së mund të mbajë edhe mbledhje tjera.

9.5. Kryetari, pasi konsultimeve me drejtorin, cakton datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes së Rregullt.

9.6. KD mund të mbajë mbledhje nëse janë të pranishëm së paku shtatë anëtarë të tij.

9.7. Mbledhjet e Këshillit Drejtues drejtohen nga kryetari e në mungesë të tij nga nënkryetari. Në mungesë të tyre mbledhjen e udhëheq ndonjë

anëtar i këshillit i autorizuar me shkrim nga kryetari, ndërsa në mungesë të personit të autorizuar, mbledhjen e udhëheqë anëtari më i vjetër i këshillit.

9.8. Këshilli Drejtues nuk mund të marrë vendime për çështjet nga neni 7.3 a deri g të këtij statuti nëse këto çështje nuk janë përfshirë më parë në agjendën e takimit.

9.9. Për çdo takim të KD-së duhet të mbahet procesverbal me shkrim ose ndonjë teknikë tjetër për incizim dhe regjistrim.

9.10. Mbledhjet e KD-së janë të hapura.

9.11. Pjesëmarrja dhe pozita e drejtorit në mbledhje është e përcaktuar me ligj, ndërsa personat tjerë mund të marrin pjesë në mbledhje me aprovimin e KD-së ose me ftesë të kryetarit.

9.12. KD mund të vendosë që ndonjë mbledhje e tij të jetë e mbyllur, dhe

9.13. Agjendat, procesverbalet, vendimet dhe parashtrësia të tjera regjistrohen jo më vonë se 15 ditë pas mbledhjes në administratën e IGJK-së.

Neni 10

Vendimet e Këshillit Drejtues

10.1 Këshilli Drejtues merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Kur votat janë të barabarta, përcaktuese është vota e kryetarit të KD-së.

10.2. Votimet e KD-së bëhen me vota të hapura (aklamacion), përveç kur 2/3 e anëtarëve të KD-së vendosin ndryshe.

10.3. Për zgjedhjen e drejtorit dhe për çështjet nga neni 7.3 a deri g, vendimet merren me dy të tretat e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

10.4. Vendimet merren pas diskutimeve dhe pas dëgjimit dhe shqyrtimit të raporteve të paraqitura nga drejtori i IGJK-se apo Këshilli i Programit.

10.5. Vendimet e KD-së nënshkruhen nga kryetari dhe vulosen me vulën e IGJK-së.

10.6. Një kopje e vendimeve i dërgohet menjëherë Drejtorit të IGJK-së i cili është i detyruar t'i zbatojë.

Neni 11

Drejtori

11.1. Instituti Gjyqësor i Kosovës administrohet dhe udhëhiqet nga Drejtori i tij.

11.2. Kushtet kryesore për emërimin e Drejtorit të Institutit janë përcaktuar me ligj.

11.3. Drejtori i Institutit emërohet nga Këshilli Drejtues pas shpalljes së konkursit publik dhe zbatimit të rregullave mbi Shërbimin Civil në Kosovë. Ai/ajo mund të rizgjidhet pa ndonjë kufizim varësisht nga performanca e tij dhe nga suksesi në kryerje të këtij funksioni.

11.4. Këshilli Drejtues përcakton rregullat shtesë për zgjedhjen e Drejtorit në pajtim me parimet e transparencës, sinqeritetit dhe qasjes së barabartë.

11.5. Drejtori i IGJK-së është shërbyes civil dhe mënyra e themelimit të marrëdhënies së tij të punës përcaktohet me rregullat e shërbimit civil në fuqi.

11.6. Drejtori mund të shkarkohet:

- a. Në bazë të kërkesës së tij/saj të bërë me shkrim;
- b. Për pamundësinë e përmbushjes së obligimeve të tij/saj në një periudhë më të gjatë se 6 muaj;

- c. Nëse dënohet më shumë se gjashtë muaj burg për një vepër penale ose me një vendim të plotfuqishëm gjyqësor i është hequr e drejta për ta ushtruar këtë funksion;
- d. Për mosrespektim të përgjegjësive nga neni 4 i ligjit dhe akteve nënligjore të IGJK-së dhe
- e. Për dështime të vazhdueshme në kryerjen e detyrave të tij/saj.

11.7. Përgjegjësitë kryesore të drejtorit janë të përcaktuara me ligj, ndërsa përgjegjësitë tjera janë si më poshtë:

- a. Është përgjegjës që në baza ditore të bëjë menaxhimin e përgjithshëm dhe organizimin e aktiviteteve të Institutit;
- b. Zhvillon plane strategjike afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për Institutin, projekt buxhete vjetore dhe dokumente tjera;
- c. Zgjedh, sistematizon dhe largon punëtorët e Institutit sipas procedurave të përcaktuara me ligj,
- d. Menaxhon pronën e Institutit,
- e. Përfaqëson Institutin para palëve të treta përfshirë edhe donatorët,
- f. Miraton përbërjen e trajnuesve dhe pjesëmarrësve për trajnime konkrete në Programin e Vazhdueshëm dhe Programin për Avancim të Trajnimeve, dhe
- g. Lidhë kontrata dhe marrëveshje mirëkuptimi në emër dhe për llogari të Institutit.

11.8. Zbaton detyrat që burojnë nga ligji, nga statuti, aktet tjera të brendshme dhe nga vendimet e Këshillit Drejtues.

11.9. Disa nga detyrat e tij/saj ose në mungesë të tij/saj, drejtori mund t'i bartë me shkrim te Koordinatorin e Programit.

KREU III

Struktura organizative

Neni 12

12.1. Veprimtaria e Institutit Gjyqësor të Kosovës zhvillohet e bazuar në Departamentin e Programeve dhe në Departamentin e Administratës dhe Financave.

12.2. Departamenti i Programeve përshinë pozitë dhe njësitë të cilat udhëheqin dhe realizojnë aktivitetet trajnuese dhe aktivitetet tjera të IGJK-së.

12.3. Departamenti i Programeve udhëhiqet nga Koordinatorin e Programit.

12.4. Koordinatorin e Programit emërohet në bazë të pikës B.5 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006-23.

12.5. Programet dhe veprimtaritë e veçanta trajnuese realizohen nga përgjegjësitë e programeve.

12.6. Departamenti i Administratës dhe Financave përfshinë sektorë të cilët janë përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve administrative dhe financiare të Institutit dhe udhëhiqet nga drejtori administrativ-financiar.

12.7. Emërtimet, llojet, numri dhe struktura organizative e funksionale e sektorëve brenda departamenteve, do të përcaktohen nga Drejtori i Institutit.

12.8. Të gjithë të punësuarit në Institut janë shërbyes civil dhe i nënshtrohen rregullave për shërbyesit civil.

12.9. Gradimin e të punësuarve në Institut e bënë drejtori.

KREU IV**Aktivitetet trajnuese****Neni 13****Provimi Përgatitor**

IGJK-ja ka përgjegjësinë për organizimin dhe vlerësimin e provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë, provim ky i cili është parakusht për fillimin e ndjekjes së kursit të trajnimeve nga personat që plotësojnë kriteret për t'iu nënshtuar dhe e kalojnë atë, si dhe pretendojnë të emërohen në postin e gjyqtarit apo prokurorit.

Neni 14**Trajnimi për bartësit potencial të funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit (PFAL)**

14.1 Ky program trajnimi iu dedikohet kandidatëve pretendentë për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm të cilët pasi ta kenë kaluar Provimin Përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë i nënshtrohen këtij programi trajnues në disa module për një periudhë të caktuar kohore.

14.2. Qëllimi i këtij programi është përgatitja e gjeneratave të reja të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të freskuar sistemin gjyqësor të Kosovës dhe për të mbështetur procesin e emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe ngritja e kapaciteteve të këtyre kandidatëve, matja dhe vlerësimi i njohurive profesionale dhe përzgjedhja e tyre për emërim si gjyqtar dhe prokuror në bazë të rezultateve të arritura gjate programit trajnues.

Neni 15**Trajnimi për bartësit e funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit (PVAL)**

15.1. Ky program trajnimi synon të mbështesë bartësit e funksioneve të gjyqtarit dhe prokurorit në ngritjen, freskimin dhe forcimin e aftësisë të vazhdueshëm ligjor të tyre, duke përfshirë këtu edhe kurse trajnimi për gjyqtarët porotë.

15.2. Çdo gjyqtarë dhe prokurorë duhet të ndjekë më së paku tri kurse trajnuese në fushat që do të përcaktohen nga autoritetet përkatëse.

Neni 16**Programi i Trajnimit për Avancim (PTA)**

16.1. Ky program përfshinë organizimin e trajnimeve të posaçme për gjyqtarë dhe prokurorë dhe realizohet për dy kategori:

a. Organizimin e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë që aktualisht ushtrojnë funksionet e tyre dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës vendosë që ata të avancohen prej rangut më të ulët në rangje më të larta të gjykatave dhe prokurorive.

b. Organizimin e trajnimeve për gjyqtarët dhe prokurorët e porsaemëruar të cilët kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në trajnimet e veçanta për aftësim dhe avancim pa shpëputje nga marrëdhënia e punës.

Neni 17**Kurse për aftësimin e profesionistëve tjerë në gjyqësi**

17.1. Përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve, IGJK do të organizojë kurse trajnimi për profesionistët tjerë në sistemin gjyqësor, që do t'i identifikojë gjatë punës së saj.

17.2. Profesionistë në sistemin gjyqësor janë bashkëpunëtorët profesionalë në gjykata dhe prokurori.

Neni 18**Hulumtimet shkencore dhe publikimet**

Aktivite me rëndësi në mandatin e IGJK-së janë hulumtimi shkencor, përmbledhja e praktikës gjyqësore, përgatitja dhe hartimi i komentareve të ligjeve, publikimin e këtyre hulumtimeve dhe përmbledhja e ligjeve.

Neni 19

Programet dhe aktivitetet trajnuese të përmendura nga neni 12 deri 17 të këtij statuti do të rregullohen me akte përkatëse nënligjore.

Neni 20**Trajnuesit e IGJK-së**

Aktivitetet për mbajtjen dhe ngritjen e aftësive profesionale të bartësve dhe bartësve potencialë të funksionit në gjyqësi, aftësimi për avancim, organizimin dhe vlerësimin e provimit përgatitor, aftësimi i profesionistëve tjerë në lëmin e gjyqësisë dhe aktivitete tjera të IGJK-së, kryhen nga trajnuesit e përhershëm dhe të përkohshëm të IGJK-së.

Neni 21**Trajnuesit e përhershëm**

21.1. Trajnuesit e përhershëm të IGJK-së mund të zgjedhën nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, profesorëve universitarë dhe studiueseve shkencorë të angazhuar që të punojnë me orar të plotë në IGJK;

21.2 Trajnuesit e përhershëm duhet:

a. Të kenë cilësi të lartë profesionale dhe morale;

b. Të kenë së paku pesë vjet përvojë të punës;

c. Të kenë përvojë si trajnues nga fusha e gjyqësisë;

d. Të kenë përfunduar kurse të specializuara trajnimi për trajnues në IGJK ose në qendra tjera trajnimesh.

21.3. Trajnuesit e përhershëm duhet të miratohen nga Këshilli Drejtues pas propozimit të bërë nga Drejtori;

21.4. Këshilli Drejtues i IGJK-së do të miratojë rregullat e përhershme për zgjedhjen e trajnuesve të përhershëm në pajtim me parimet e kompetencës, transparencës dhe qasjes së hapur e të barabartë;

21.5. Trajnuesit e përhershëm punojnë me kontratë të punës. Gjatë kësaj kohe ata marrin pagën e njëjtë me gjyqtarin e gjykatës së qarkut;

21.6. Trajnuesit e përhershëm duhet të:

a. Mbajnë kurse trajnimi në të gjitha programet trajnuese të IGJK-së;

b. Përgatitin materiale trajnuese dhe materiale ndihmëse;

c. Përgatitin dhe freskojnë planprogramin së bashku me Këshillin Programor, dhe

d. Bëjnë vlerësimin e vazhdueshëm të rezultateve të trajnimeve.

Neni 22**Trajnuesit e përkohshëm**

22.1. Trajnuesit e përkohshëm duhet të jenë ekspertë nga praktika gjyqësore dhe ekspertë ligjorë të cilët:

- a. Janë specialistë të çështjeve të caktuara për të cilat do të mbajnë trajnime;
- b. Kanë cilësi të larta profesionale dhe morale;
- c. Kanë përvojë si trajnues ose kanë kryer trajnime të posaçme për trajnues, të organizuara nga IGJK-ja apo institucione tjera të ngjashme, dhe
- d. Kanë vlerësime të mira nga pjesëmarrësit e trajnimeve ku ata kanë prezantuar si trajnues.

22.2. Këshilli Drejtues i IGJK-së do të miratojë rregullat për zgjedhjen e trajnuesve të përkohshëm në pajtim me parimet e kompetencës, transparencës dhe qasjes së hapur e të barabartë;

22.3. Trajnuesit e përkohshëm miratohen nga Drejtori i Institutit pas konsultimeve me anëtarët e Këshillit Programor;

22.4. Trajnuesit e përkohshëm duhet të angazhohen për trajnime të veçanta ose ngjarje të veçanta trajnuese në bazë të kontratës mbi veprën;

22.5. Trajnuesit e përkohshëm marrin kompensim nga buxheti i IGJK-së dhe shpërblimi i tyre do të përcaktohet me akt të veçantë nga drejtori i Institutit, dhe

22.6. Metodologjia, të drejtat dhe obligimet e trajnuesve do të përcaktohet me akt të veçantë.

Neni 23**Këshilli Programor**

23.1. Këshilli Programor është organ ndihmës i IGJK-së me funksione këshilluese.

23.2. Anëtarë të përhershëm të Këshillit Programor janë Drejtori i Institutit dhe Koordinatori i Programit.

23.3. Anëtarët tjerë të Këshillit Programor miratohen nga KD-ja me propozim të drejtorit dhe do të jenë me këtë përbërje:

- a. Një gjyqtar, përfaqësues i Këshillit Drejtues;
- b. Një prokuror, përfaqësues i Këshillit Drejtues, dhe
- c. Një profesor nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës.

23.4. Këshilli Programor i realizon aktivitetet në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Gjyqësor, kryetarët e gjykatave të qarkut, përfaqësuesin e Kryeprokurorit të Kosovës dhe përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë.

23.5. Anëtarët e Këshillit Programor të cilët nuk janë të punësuar në IGJK marrin kompensim dhe pagesa e tyre përcaktohet nga Këshilli Drejtues.

23.6. Anëtarët e Këshillit Programor duhet të:

- a. Marrin pjesë në përgatitjet dhe freskimin e programeve trajnuese;
- b. Marrin pjesë në procesin e zgjedhjes së trajnuesve;
- c. Këshillojnë organet udhëheqëse të Institutit për çështje të ndryshme nga fusha e ligjit, shkencës dhe praktikës, dhe
- d. Themelojnë dhe mbajnë marrëdhënie me institucione vendore dhe ndërkombëtare, universitete, organizata profesionale të juristëve, avokatëve, etj., veprimtaria e të cilave është e lidhur me aktivitete e Institutit.

23.7. Këshilli Programor takohet së paku çdo tre muaj ose kurdo që është e domosdoshme me thirrje nga Drejtori.

23.8. Këshilli Programor mund të mbajë mbledhjen nëse së paku një e dyta (1/2) plus një anëtar i tij janë prezent dhe mund të marrë vendime me shumicën e votave të anëtareve të pranishëm.

23.9. Mbledhjet e Këshillit Programor udhëhiqen nga Drejtori i Institutit, i cili në të njëjtën kohë koordinon aktivitetet e këtij këshilli.

23.10. Në mbledhjet e Këshillit Programor mbahet procesverbal me shkrim, i cili duhet të nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit.

KREU V

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 24

24.1. Procedura për ndryshimin e Statutit mund të fillohet me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të KD-së, apo me propozimin me shkrim të Drejtorit.

24.2. Ndryshimi i Statutit bëhet pas miratimit nga 2/3 e anëtarëve të pranishëm në mbledhje të KD-së.

Neni 25

Të gjitha aktet tjera të IGJK-së duhet të nxirren në pajtim me Statutin.

Neni 26

Versioni në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe do të jenë autentike. Në rast mosmarrëveshjeje, mbizotëron versioni në gjuhën shqipe.

Neni 27

Statuti hyn në fuqi 8 ditë pasi që të miratohet nga Këshilli Drejtues i IGJK-së.

Prishtinë, 25 janar 2008

Kryetari i Këshillit Drejtues

Prof.dr. Vesel Latifi